

# AKT THEMELIMI I SHOQËRISË TREGTARE

## **“FIENERGI” shpk**

Fier më datë 13/07/2022

### **NENI 1**

Shoqëria Tregtare “FIENERGI” sh.p.k (në vazhdim Shoqëria) formohet si shoqëri tregtare sipas ligjit 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” të ndryshuar dhe do të funksionojë në bazë të këtij akti themelimi dhe statuti të miratuara prej saj.

### **NENI 2**

#### **Emri i Shoqërisë**

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko-civil me emrin “FIENERGI” sh.p.k

### **NENI 3**

#### **Objekti i veprimtarisë**

Shoqëria do të ketë si objekt ushtrimin e të gjitha veprimtarive në fushën e energjisë, konkretisht:

1. Prodhimi, transmetimi, shpërndarja dhe shitja e energjisë;
  2. Prodhimi i gazit; shpërndarja e lëndëve të gazta nëpërmjet tubacioneve;
  3. Projektimi, ndërtimi, rehabilitimi dhe fuqizimi i centraleve për prodhimin e energjisë dhe infrastruktura e impianteve. Kërkimi dhe zhvillimi i impianteve dhe aparaturave për prodhimin e energjisë;
  4. Asistenca teknike, riparime dhe mirëmbajtja e aparaturave për prodhimin e energjisë. Import- eksporti, tregtimi me shumicë dhe pakicë i energjisë elektrike, mallrave, materialeve dhe aparaturave që lidhen me kryerjen e aktivitetit në fushën e energjisë;
  5. Instalimi dhe ndërtimi i impianteve energjitike nga burime të rinovueshme nga dielli, era, uji, etj;
  6. Prodhimi, transmetimi, shpërndarja dhe shitja e energjisë nga burime të rinovueshme;
  7. Importi dhe eksporti i mallrave e pajisjeve të teknologjisë në fushën e energjetikës, që do të përdoren në ndërtimin, mirëmbajtjen dhe menaxhimin e centraleve me impiante fotovoltaike e forma të tjera të prodhimit të energjisë të ushqyera nga burime të ndryshme dhe nga ato të caktuara si: hidroelektrike, diellore, me erë, biomasa etj;
  8. Mirëmbajtja e centraleve energjitike;
  9. Zhvillim të projekteve në sektorin e energjive të rinovueshme, ndërtimin dhe mirëmbajtje të punimeve civile, objekteve të ndryshme, linjave elektrike, kërkim dhe zhvillim të shpellave dhe minierave.
-

#### **NENI 4**

##### **Selia e Shoqërisë**

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresë: L.16 Prilli, Rr. Llukan Toska, Zona kadastrale 8534, Ndertesa 2 kateshe, kati 0, Fier

#### **NENI 5**

##### **Kapitali i Shoqërisë**

Kapitali themeltar i nënshkruar i shoqërisë do të jetë i përbërë nga kontributi i ortakëve themelues të kësaj Shoqërie, në para në vlerën 100.000 lekë dhe nuk është paguar. Kapitali ndahet në 5 (pese) pjesë dhe pronësia e kuotave nga ortakët e shoqërisë vijon si më poshtë:

1. **Z.Krienko Qazo Memo**, lindur me 08/01/1960, ne Fier-Shqipëri, shtetas shqiptar, identifikuar nëpërmjet kartës së identitetit nr.**ID G00108015E**, në cilësinë e ortakut themelues zotëron **27 %** të vlerës së kapitalit themeltar, e barabartë me 1 kuotë me vlerë **27.000 Lekë**.
2. **Znj.Elsa Selim Baci**, lindur më 26/03/1974 në Matohasanaj, Shqipëri, shtetas shqiptar, identifikuar nëpërmjet kartës së identitetit nr.**ID H45326088E**, në cilësinë e ortakut themelues zotëron **27 %** të vlerës së kapitalit themeltar, e barabartë me 1 kuotë me vlerë **27.000 Lekë**.
3. **Z.Dilaver Idai Kamberaj** , lindur më 31/03/1970 në Fier, Shqipëri, shtetas shqiptar, identifikuar nëpërmjet kartës së identitetit nr.**ID H00331120R**, në cilësinë e ortakut themelues zotëron **20 %** të vlerës së kapitalit themeltar, e barabartë me 1 kuotë me vlerë **20.000 Lekë**.
4. **Z.Artur Zalo Cakaj**, lindur më 28/03/1960 në Fier, Shqipëri, shtetas shqiptar, identifikuar nëpërmjet kartës së identitetit nr.**ID G00328033Q**, në cilësinë e ortakut themelues zotëron **16 %** të vlerës së kapitalit themeltar, e barabartë me 1 kuotë me vlerë **16.000 Lekë**.
5. **Z.Agim Lasko Mero**, lindur më 12/05/1962 në Fier, Shqipëri, shtetas shqiptar, identifikuar nëpërmjet kartës së identitetit nr.**ID G20512076T**, në cilësinë e ortakut themelues zotëron **10 %** të vlerës së kapitalit themeltar, e barabartë me 1 kuotë me vlerë **10.000 Lekë**.

#### **NENI 6**

##### **Kohëzgjatja e shoqërisë**

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat kohor të pacaktuar. Afati i aktivitetit fillon mbas regjistrimit të Shoqërisë në Regjistrin Tregtar.

#### **NENI 7**

##### **Organet Drejtuese**




Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008” Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve – organi më i lartë vendimmarrës;
2. Administrator – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

Mënyra e organizimit të tyre dhe funksionimit është e përcaktuar në Statutin e Shoqërisë.

Shoqëria do të administrohet nga Administratori, i cili zgjidhet për një afat 5 vjeçar me të drejtë rigjedhjeje. Administratori i parë i shoqërisë është **z Vilçens Grëmi**, lindur me 26/10/1982 ne Kolonje, Shqiperi.

Nenshkrimi i Administratorit



Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratori, i cili ushtron këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

#### **NENI 8**

Ekspertët kontabël të autorizuar të Shoqërisë do të emërohen në përputhje me ligjin në fuqi dhe për çdo vit vit financiar vjetor për veprimtarinë e shoqërisë.

#### **NENI 9**

Ortakët themelues mund të vendosin me vullnetin e tyre, për pjesëmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojnë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

#### **NENI 10**

Organizimi dhe funksionimi i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

#### **NENI 11**

Ortakët detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

#### **NENI 12**

---

Mosmarrëveshje që mund të lindin midis ortakëve apo midis ortakëve dhe Shoqërisë dhe të cilët mund të kenë si objekt të drejta si rrjedhim i raporteve me shoqërinë do të zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.


### NENI 13

Dispozitat përfundimtare


Akt Themelimi hartohet në 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe.

### ORTAKET


Krienko Memo




Elsa Baci



Dilaver Kamberaj



Artur Cakaj



Agim Mero

